Interesa afatgjatë në pjesëmarrjet sipërmarrjet e përbashkëta

(Ndryshime të SNK 28)

© IFRS Foundation

Ndryshimet në
SNK 28 *Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta*

Janë shtuar paragrafët 14A dhe 45F-45J dhe është fshirë paragrafi 41. Teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Metoda e kapitalit neto

…

14A Një njësi ekonomike gjithashtu zbaton SNRF 9 për instrumente të tjerë financiarë në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, për të cilat nuk aplikohet metoda e kapitalit neto. Këto përfshijnë interesa afatgjata që, në thelb, janë pjesë e investimit neto të njësisë ekonomike në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët (shih paragrafin 38). Një njësi ekonomike zbaton SNRF 9 për interesa të tillë afatgjatë para se të zbatohet paragrafi 38 dhe paragrafët 40-43 të këtij standardi. Në zbatimin e SNRF 9, njësia ekonomike nuk merr parasysh ndonjë rregullim të vlerës kontabël të interesave afatgjata që rrjedhin nga zbatimi i këtij standardi.

…

Zbatimi i metodës së kapitalit neto

…

41 [Fshirë] ~~Njësia ekonomike zbaton kërkesat e zhvlerësimit në SNRF 9 për interesat e tjera të saj në pjesëmarrjet ose sipërmarrjet e përbashkëta që janë në kuadër të SNRF 9 dhe që nuk janë pjesë e investimit neto.~~

…

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

…

45F *Interesat afatgjatë në pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta*, e botuar në Tetor 2017, ka shtuar paragrafin 14A dhe ka fshirë paragrafin 41. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8, për periudhat vjetore, që fillojnë më 1 janar 2019 ose më pas, me përjashtim të rasteve siç specifikohet në paragrafët 45G - 45J. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

45G Një njësi ekonomike që zbaton për herë të parë ndryshimet në paragrafin 45F në të njëjtën kohë aplikon për herë të parë SNRF 9, duhet të zbatojë kërkesat e periudhës kalimtare në SNRF 9 për interesat afatgjatë të përshkruara në paragrafin 14A.

45H Një njësi ekonomike që zbaton për herë të parë ndryshimet në paragrafin 45F pasi ka zbatuar për herë të parë SNRF 9 do të zbatojë kërkesat e periudhës kalimtare të SNRF 9 të nevojshme për zbatimin e kërkesave të përcaktuara në paragrafin 14A për interesat afatgjatë. Për këtë qëllim, referencat për datën e zbatimit fillestar të SNRF 9 do të lexohen duke iu referuar fillimit të periudhës raportuese vjetore në të cilën njësia ekonomike zbaton për herë të parë ndryshimet (data e zbatimit fillestar të ndryshimeve). Njësia ekonomike nuk është i detyruar të riparaqesë periudhat e mëparshme për të pasqyruar zbatimin e ndryshimeve. Njësia ekonomike mund të riparaqesë periudhat e mëparshme vetëm nëse, është e mundur pa përdorimin e gjykimit retrospektiv.

45I Kur zbaton për herë të parë ndryshimet në paragrafin 45F, një njësi ekonomike që zbaton përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 në përputhje me SNRF 4 *Kontratat e Sigurimeve*, nuk i kërkohet të riparaqesë periudhat e mëparshme për të pasqyruar zbatimin e ndryshimeve. Njësia ekonomike mund të riparaqesë periudhat e mëparshme vetëm nëse, është e mundur pa përdorimin e gjykimit retrospektiv.

© IFRS Foundation

45J Nëse një njësi ekonomike që zbaton paragrafin 45H ose paragrafin 45I dhe që nuk riparaqet periudhat e mëparshme, në datën e zbatimit fillestar të ndryshimeve, ajo duhet të njohë në fitimet e pashpërndara (ose një përbërës tjetër më të përshtatshëm të kapitalit neto) çdo diferencë midis:

(a) shumës së mëparshme të mbartur të interesave afatgjatë të përshkruar në paragrafin 14A në atë datë; dhe

(b) vlerës kontabël të atyre interesave afatgjatë në atë datë.